

PERMBLEDHJE E RAPORTIT PARAPRAK PER VLERESIMIN E NDIKIMIT NE MJEDIS TE
AKTIVITETIT

“LINJE E PRODHIMIT DHE AMBALAZHIMIT TE UJIT TE PIJSHEM”

SUBJEKTI: FATOS GEGA

VENDODHJA E OBJEKTIT: RRETHI LIBRAZHD, KOMUNA RRAJCE, FSAHTI RRAJCE-
FUSHE, RRUGA NACIONALE PRRENJAS-POGRADEC, KILOMETRI 3, ZONA
KADASTRALE NR.3203, NR.PASURISE 21/66.

MARS 2015

1 Hyrje.

1.1 Kuadri ligjor mjedisor

1.2 Metodika dhe qellimi i vleresimit.

1.3 Pershkrimi i projektit

2 .Te dhena per mjedisin ekzistues te zones ku zbatohet projekti.

2.1 Vendndodhja gjeostrategjike e rajonit.

2.2 Popullsia dhe gjendja e infrastructures se zones

2.3 Gjeologjia dhe gjeomorfologjia

2.4 Sizmiciteti

2.5 Klima.

2.6 Ekosistemet, flora, fauna.

2.7 Hidrogeologjia

2.8 Trashegimia arkitektonike, arkeologjike dhe historike.

2.9 Peizazhi dhe topografia.

2.10 Statusi i zones.

3. Vleresimi i ndikimeve me te rendesishme ne mjedis.

3.1 Vleresim i ndikimeve kryesore ne mjedisin e studiuar.

3.1.1 Efektet ne cilesine e ajrit.

3.1.2 Vibrimi dhe zhurmat.

3.1.3 Ndikimet ne toke dhe erozioni i saj.

3.1.4 Ndikimet e projektit ne modelin drenazhues te zones.

3.1.5 Ndikimet ne ujerat nentokesore.

3.1.6 Ndikimet ne flore dhe faune.

3.1.7 Ndikime te tjera indirekte qe shoqerojne projektin

4. Permbledhje te efekteve kryesore qe ndikojne ne mjedis.

4.1. Efektet kryesore negative.

4.2 Efektet kryesore pozitive.

5. Masat zbutese.

6. Rreziku per aksidente

6.1. Sigurimi teknik dhe mbrojtjane pune

6.2. Rregullore e pergjithshme e sigurimit teknik

6.3.Rregullore e sigurimit teknik ne vendin e punes

7.Monitorimi i ndikimit ne mjedis te projektit.

8. Rekomandime

9. Konkluzione

1. HYRJE

Uji ka rendësi të madhe për njerëzimin por edhe për kafshët. Rreth 3/4 e tokës është ujë. Uji gjendet kudo në natyrë, edhe në trupin e njeriut edhe në trupin e kafshëve. 95 % e trupit të njeriut është ujë. Uji ka rendësi edhe në bujqësi e blegtori. Uji ka rendësi për bujqësinë sepse me ujë ujiten bimët e ndryshme pa të cilin bimët s'mund të jetojnë. Uji ka rendësi edhe në blegtori të gjitha kafshët e kanë një pjesë të trupit me ujë, gjithashtu ka dobi edhe se të gjitha kafshët pin ujë. Jeta e njeriut nuk do të ishte e mundur pa ujë sepse : njeriu e shfrytëzon atë për shumë gjera, për pastrim, pirje etj. Gjithashtu uji ka rendësi edhe në tregti (biznes) sepse subjekte të ndryshme e filtrojnë ujin dhe e shesin atë e kështu ato kanë të ardhura të larta. Dihet se njeriu mund të jetojë rreth një muaj pa ushqim, por vetëm 5 deri në 7 ditë pa ujë!

Uji është lëng pa erë, pa shije dhe pa ngjyrë. Njeriu humbë çdo ditë rreth 1.5 deri 2.5 litra ujë, gjë që duhet zëvendësuar me anë të pirjes së rregullt të ujit. Rreth 2/3 e peshës trupore përbëhet nga uji. Kjo sasi uji nuk është e njëjtë tek të gjithë, varet nga mosha dhe gjinia.

Nga mungesa e ujit rritet rreziku i sëmundjes së veshkëve, bllokimi dhe infeksioni i rrugëve të urinimit, tharja e lëkures dhe mukozes, që mundëson depërtimin më të lehtë të virusëve dhe bakterieve në mbrendi të trupit.

Gjatë temperaturave të larta, aktiviteve të rënda fizike, diuresë dhe etheve, shtohet nevoja për ujë. Ata që djersiten shumë, ata që shpesh janë në lëvizje e udhëtim ose ata të cilët me kënaqësi shkojnë në saunë, duhet të llogarisin se duhet shtuar sasinë e ujit deri më tri herë! Etja shkaktohet kur trupi ynë ka humbur më shumë se 0.5 % të peshës në formë të ujit, d.m.th. një person që peshon 70 kg ndjen etje pas një humbje prej 350 ml të ujit.

Shpesh ndodh që kjo ndjesi të mos perceptohet e sidomos në pleqëri, kur bie aktiviteti i qelizave dhe receptorëve që perceptojnë etjen. Në gjendje stresi fare pak mund të perceptojmë etjen, që ka për pasojë zvogëlimin e koncentrimin dhe shfaqjen e lodhjes. Shkaktarë i shpeshtë i kokëdhembjeve është uji i pakët në organizëm.

Uji ndihmon të humbni në peshë, pa marrë parasysh se ç'loj diete mbani. Uji nuk përmban kalori, por ndihmon në harxhimin e energjisë p.sh. ata që pinë 1.5 deri 2 litra ujë (edhe ata që vuajnë nga mbipeshja) në ditë bëjnë djegien e 100 kilokalorive (rreth 7000 kcal përmban 1 kg ind djamor). Gjatë çdo ngrënie, shoqëroni ushqimit lëngje, e veçanërisht preferohet 0.5 l ujë (jo të ftohtë) para ushqimit, sepse mbush lukthin dhe stimulon metabolizmin. Varësisht nga mbingarkesat dhe aktivitetet fizike që kryejnë individë të caktuar, marrja e lëngjeve në sasi të madhe është e domosdoshme.

Uji në formën e tij të pastër, është lëng pa shije dhe pa erë. Ai është i domosdoshëm për të gjitha format e **jetës** dhe njihet edhe si tretësi më i gjithanshëm. Pa të, jeta siç e njohim ne, do të ishte e pamundur. Duket i pangjyrë në sasi të vogla për syrin tonë, megjithëkëtë mund të shihet si **i kaltër** në

sasi të mëdha ose me vegla shkencore. Uji është një lëngu më i përhapur në tokë. Formula kimike e tij është H_2O . Gjetet më tepër në oqeanë dhe kësulata e akullta polare, por edhe në re, lumenj. Në planetin tonë, uji është në lëvizje të vazhdueshme qarkulluese duke përfshirë avullimin, reshjet dhe derdhjen në det.

Uji i përshtatshëm për t'u pirë nga njeriu quhet ujë i pijshëm. Uji që nuk është i përshtatshëm për t'u pirë, por që nuk është i rrezikshëm për njerëzit dhe quhet ujë i sigurt.

Ky burim natyror po bëhet gjithnjë e më tepër më i pakët në disa vende, dhe sigurimi i tij është shqetësim i madh shoqëror dhe ekonomik

Uji është një tretës shumë e mire dhe tret shumë lloje substancash. Substancat që treten mire në ujë quhen hidrofilike, mund të themi janë mjet të ujit. Substancat që nuk treten mire në ujë quhen hidrofobike mund të themi se kanë frikë nga uji.

Uji duhet të jetë i lehtë dhe pak i mineralizuar. Sasia e mineraleve të tretura në ujë është një tregues bazë për ujin mineral natyral, paraqitur në etiketë në formën e parametrin "Mbetje e thatë në $180^{\circ}C$ në mg / l". Sa më e ulët të jetë kjo vlerë, aq më i mirë është uji. Ujërat me mbetje të thatë nën 150 mg/l konsiderohen ujëra të lehtë.

Uji duhet të jetë i pasur në minerale të dobishme për trupin e njeriut. Ndër mineralet e dobishme përmenden: Magnezi që mbron zemrën, veshkat, sistemin muskular dhe ndihmon tretjen, Kalciumi si element integruar i kockave dhe i rëndësishëm për sistemin dentar, Bikarbonatet në sasi të konsiderueshme ndihmojnë tretjen dhe janë pozitive për asimilimin e energjisë në formën e duhur, etj. Substancat që duhet të jenë prezente në sasi të limituara janë Natriumi i cili në sasi të mëdha pengon procesin e qarkullimit të ujit në organizëm, Nitratet që janë substanca ndotëse dhe gjithashtu produkti nuk duhet të shfaqë asnjë prezencë Nitritesh.

Uji ka formulën kimike H_2O që domethënë se një molekulë uji përbëhet nga 2 atome hidrogjen dhe një oksigjen. Mund të përshkruhet jonikisht si HOH, me jonin hidrogjen (H^+) i lidhur me grupin hidroksid (OH^-). Uji është në ekuilibër dinamik midis gjendjes së gaztë dhe asaj të lëngët në temperaturë dhe tryzni standarde. Uji në vetvete është pa shije dhe pa ngjyrë por në kontakt të gjatë me ajrin lidhet me dyoksidin e karbonit (CO_2) dhe merr një shije të athët acidi karbonik që nuk është i mirë për shëndetin.

Uji është një përbërësi shumë i rëndësishëm për organizmin tonë dhe për mendjen, që edhe një rënie e vogël prej 2% në total të peshës trupore mund të shkaktojë një alternim të temperaturës dhe deri tek mungesa e të menduarit.

Të pini ujë është një nevojë fiziologjike, por ndonjëherë nuk jemi të qartë sa ujë duhet të konsumojmë në dite.

Nuk është shumë e rëndësishme që uji që zgjedhim të jetë natyral apo i gazuar, e rëndësishme është që të sigurojmë sasinë e duhur të ujit në ditë, duke rregulluar kushtet hidrike të organizmit, mbi të gjitha në disa momente të vitit si në verë apo në dimër. Atëherë të shohim sa ujë duhet të konsumojmë në ditë dhe disa këshilla praktike.

Sigurisht, sa herë që ndjejmë etje, por gjatë ditës, ideale do të ishte një gotë ujë çdo një orë, duke filluar me një gotë me stomakun bosh sapo të ngriheni, perfekt do të ishte ujë i ngrohtë me limon. Të mbyllni ditën me një gotë ujë apo një çaj relaksues.

E rëndësishme është të mos lini pas dorë konsumin e ujit, sepse mund t'iu krijoj probleme.

Siç po thoshim uji nuk duhet të pihet menjëherë, por në harkun kohor e të gjithë ditës, për të mbajtur konstante hidratimin e organizmit. Duhet të zgjidhet edhe në bazë të nevojave.

Nëse ushqimi është i ndryshëm, i pasur me fruta dhe perime, supë, qumësht, çajë etj uji në këtë mënyrë merret nga këto ushqime. Sasia e ujit mund të lidhet edhe me llojin e dietës që ndiqni, nga regjimi ushqimor në përgjithësi.

Etapa e re e zhvillimit të vendit, ka sjelle zhvillimin të kesaj zone me komplekset e ndryshme të prodhimit industrial, ekspozimit, të shërbimit, etj. Zona ku ushtron aktivitetin subjekti është Komuna Rrajce, fshati Rrajce dhe linja e prodhimit dhe ambalazhimit të ujit dhe pijeve jo alkolike është e ndërtuar në këtë zonë dhe zë një sipërfaqe prej 112 m².

Zona ka godina të reja, infrastrukture të re dhe vetë objekti rreth tij ka një sipërfaqe të konsiderueshme të gjelber.

Në këtë zonë ndodhet një sërë objektesh tregtare, autoservise dhe lavazhe të ndryshme dhe në thellesin ndodhen minierat e shfrytëzimit të tehekur nikelit dhe kromi, pra kemi rritje të madhe të bizneseve dhe si rrjedhojë edhe të numrit të ndërtimeve për banim dhe shërbim, ndërtimeve për qelime industriale edhe për arsye të pozicionit të zonës si dhe lehtësisë së komunikacionit.

1.1. Kuadri Ligjor Mjedisor

a.1 Baza ligjore ku mbështetet veprimtaria e projektit

Për zgjidhjen e projektit të linjes së prodhimit dhe ambalazhimit të ujit të pijshëm Rrajce, teknologjinë e zbatimit, projektuesit janë mbështetur në ligjislacionin mjedisor të miratuar në Republikën e Shqipërisë dhe rregulloret e ndryshme për mjedisin. Gjithashtu subjekti do të marrin përsiper të zbatojnë me korrektësi normat e përmirësuara në të ardhmen në drejtim të ndotjes së mjedisit dhe ato higjienike.

Në kuadrin aktual ligjor për VNM -në kryesoret janë:

- Ligji Nr.10448, datë 14.07.2011, "Për Lejet e Mjedisit".

Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës. Përcakton detyrimet për pajisjen me Leje Mjedisore të subjekteve fizike dhe juridike që kërkojnë të ushtrorjnë një veprimtari që ka ndikime në mjedis. Kreu IV i këtij ligji "Leja për veprimtaritë që ndikojnë në mjedis" Nenet 35-48 përcaktojnë modalitetet e marrjes së lejes mjedisore.

- **Ligji Nr.10463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”**

Ky ligj ka për qëllim të mbrojë mjedisin e shëndetin e njeriut dhe të sigurojë menaxhimin e duhur mjedisorë të mbetjeve nëpërmjet:

- a) parandalimit e minimizimit të mbetjeve ose pakësimit të ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve;
- b) përmirësimit të efikasitetit të përdorimit të tyre;
- c) pakësimit të ndikimeve negative të përgjithshme nga përdorimi i burimeve.

- **Ligji Nr.10431, date 09.06.2011, ne nenin 26 te tij ” ”Per mbrojtjen e mjedisit”**

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Ky ligj përcakton parimet, kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit në Republikën e Shqipërisë.

- **Ligji Nr.10 440, datë 07.07. 2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis”**

Ky ligj ka për qëllim të sigurojë:

a) një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim;

b) garantimin e një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur; si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.

Në të percaktohen dhe natyra e procesit të shqyrtimit të VNM a) proces i thelluar i VNM b) proces i përmbledhur.

Ligji Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të Mbetjeve të Ngurta”.

Ky ligj synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta, nëpërmjet administrimit mjedisor të tyre në çdo fazë, përfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin, të cilat çojnë në pakësimin e mbetjeve dhe zvogëlimin e ndikimeve të tyre të rrezikshme e të dëmshme.

Ligji Nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotur”

Ky ligj ka për qëllim të mbrojë mjedisin dhe shëndetin e njeriut nga ndikimet negative të ujërave të ndotura, duke përcaktuar rregullat e trajtimit mjedisor të tyre, si dhe detyrimet e shkarkuesve të ujërave të ndotura.

Objekt i zbatimit të këtij ligji janë:

a) ujërat e ndotura urbane;b) ujërat e ndotura industriale, sipas degëve të veçanta të industrisë; c) ujërat nga kullimi i tokave bujqësore; ç) ujërat e ndotura të çdo lloji.

Në përputhje me kërkesat e këtij ligji, personat fizikë dhe juridike duhet të marrin masa që të ulin në vijimësi sasinë e ujërave të përdorura, që shkarkojnë në mjedisin pritës dhe të pakësojnë shkallën e ndotjes së ujërave që shkarkojnë, sidomos të ndotjeve me lëndë e mbetje të rrezikshme (shkronja a dhe b e pikës 1 të nenit 6).

- **Ligji Nr.9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”**

Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e shëndetit dhe e mjedisit nga zhurmat, duke përcaktuar mënyrën e shmangies dhe masat për parandalimin, reduktimin dhe zhdukjen e efekteve të dëmshme të ekspozimit ndaj tyre, përfshirë bezdinë nga zhurma. Ligji zbatohet për zhurmën, ndaj së cilës njerëzit ekspozohen në mjedisin ku ndodhen (mjediset e zonave të banimit,

institucionet e ndryshme, zonat me aktivitet social-ekonomi, mjedise urbane dhe parqet publike). Ligji nuk zbatohet për zhurmën e lëshuar brenda vendeve të punës.

Legjislacioni mjedisor është ndërtuar edhe për të mbrojtur dhe parandaluar komponente të veçantë dhe të rëndësishëm të mjedisit. Kështu, ndër më specifiket mund të përmendim:

- Ligji Nr.9587, date 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”
- Ligji Nr. 8766, date 05.04.2001, “Të mbrojtjes ndaj zjarrit”.
- Ligji Nr. 9108, date 17.07.2003, “ Për substancat dhe preparatet kimike”.
- Ligji Nr.7941, date31.05.1995,” Per ushqimin”;
- Ligji Nr.9531, date11.09.2003,”Per mbrojtjen e konsumatoreve”;
- Ligji Nr.9308, date04.11.2004,”Per sherbimin dhe inspektoriatin sanitar”;
- Ligji Nr.9199, date 26.02.2004,”Per prodhimin, perpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve “BIO”;
- V.K.M. Nr.1189, date 18.01.2009,”Per rregullat dhe procedurat per hartimin dhe zbatimin e programit kombetar te monitorimit te mjedisit”;
- V.K.M. Nr. 435, date 12.09.2002, “Për normat e shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”.
- V.K.M. Nr. 249, date 24.04.2003, “Për dokumentacionin për Leje Mjedisore dhe të elementëve të Lejes Mjedisore”.
- VKM Nr. 268, date 24.04.2003,“Për çertifikimin e specialisteve, për V.N.M. dhe auditimin mjedisor”.
- V.K.M. Nr. 177, date 31.05.2005, “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse”.
- Udhëzimi Nr.429, date 17.11.2009, i Ministrisë së Mjedisit, “Për rregullat dhe procedurat për paisjen me leje mjedisi në kuadër të Qendrës Kombëtare të Liçensimit”.
- Udhëzimi Nr.6, date 27.12.2006, “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të ndikimit në mjedis të një veprimtarie”.
- V.K.M.Nr.587, date 07.07.2010, ”Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike”.
- Udhëzimin Nr.8, date 27.11.2007, ”Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara.

Procedura e përgatjes së Raportit të V.N.M. në vlerësim

Bazuar ne Ligjin Nr.10 440, datë 07.07. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, dhe udhëzimeve të dala në zbatim të tij. Vlerësojmë se kjo veprimtari do të pajiset me Leje Mjedisore tipi B dhe do të nënshtrohet vlerësimit të ndikimit në mjedis i përmbledhur, të përgatitjes së raportit të VNM.

Projektet publike dhe private të personave fizik dhe juridik, vendas ose të huaj, që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që mund të ndikojnë në Mjedis, i nënshtrohen në përgatitjen e një Raporti të përmbledhur të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, përpara miratimit dhe zbatimit të tyre.

Raporti i VNM është hartuar për të identifikuar ndikimet negative në mjedis të veprimtarisë dhe propozimet për masat zbutëse të ndikimeve negative.

1.2. METODIKA DHE QELLIMI I VLERSIMIT.

Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis është bazuar në rëndësinë e hartimit të studimeve urbanistike rajonale dhe mjedisore me standarde bashkëkohore, për përmbushjen e kërkesave të pronarëve të zonës ku projekti do të realizohet, pasurite natyrore dhe humane të zonës në studim, si dhe vlerat e vecanta të tyre. Identifikimi i efekteve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutëse duke pasur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike të investitorëve, masat orientuese dhe shfrytëzimi racional i burimeve natyrore si dhe bashkërendimi i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të zonës me kërkesat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Ne nenin 4–er te Ligjit “Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” theksohet ne menyre te qarte se cilat projekte i nenshtrohen vleresimit e ndikimit ne mjedis, ku thuhet se: ”Procesit te vleresimit te ndikimit ne mjedis i nenshtrohen te gjitha projektet dhe veprimtarite , qe jepen ne shtojcen 1 dhe 2 te ketij ligji, perpara miratimit te tyre nga organet perkatese”.

Projektet dhe veprimtarite i nenshtrohen dy niveleve te shqyrtimit per vleresim te ketij ndikimi:

1. Procesit te thelluar te vleresimit te ndikimit ne mjedis(VNM), te ciles I nenshtrohen projektet e shtojces 1 dhe projektet e veprimtarise qe kerkojne te zbatohen ne nje Zone te Mbrojtur.
2. Procesit te permbledhur te vleresimit te ndikimit ne mjedis(VNM), te cilat I nenshtrohen projektit te shtojces 2 dhe ndryshimeve ose rikonstrukcionet e projekteve te shtojces 1.

Mbeshtetur ne udhezimin Nr. 2 date 21. 05. 2007 , arrijme ne konkluzionin se: “Ky projekt i marre ne vleresim do t’i nenshtrohet procesit te permbledhur te vleresimit te ndikimit ne mjedis(VNM), pasi projekti ben pjese ne listen e veprimtarive vendore qe pajisen me leje mjediosre tipi B”.

Qellimi kryesor i ketij vleresimi eshte te identifikojme efektet e mundshme ne Mjedis , marrja e masave te domosdoshme per minimizimin dhe parandalimin e efekteve te krijuara ne mjedis nga venia ne jete e ketij projekti; rehabilitimi i te gjithë sektorit perpara venies ne shfrytezim te objektit per projektin ne vleresim, si dhe te lihen detyra dhe projekte per investitorin ne sherbim te komunitetit dhe me gjere.

1.3. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Ky vleresim i ndikimit ne mjedis do te paraqese nje informacion te shkurter te projektit qe eshte realizuar, ne ushrimin e veprimtarise nga Subjekti Fatos Gega. ndikimet pozitive dhe negative ne mjedis dhe masat qe investitori do te marre per zbatimin e kriterëve te nevojshme per mbrotjen dhe menaxhimin sa me racional te mjedisit.

Theksojme se shume nga vleresimet e detajuara te ndikimeve te mjedisit mbeshteten ne informacionet inxhinierike qe duhet te merren parasysh. Vleresimi identifikon ne menyre te qarte si perfitimet pozitive edhe negative dhe percakton "rezultate te pergjithshme" per sejcilen prej tyre. Vleresimi identifikon nese ndikimet jane mesatare te pranueshme, te rendesishme, te terthorta apo te drejtperdrejta.

Objekti, ku ushtron veprimtarine subjekti eshte banese e marre me kontrate

Subjekti ushtron veprimtarine ne “Prodhimin e ambalzhimin e ujit te pishem dhe pijeve jo alkalike” per banoret e zones dhe me gjere. Ky studim mjedisor percakton disa kriterë parimore mbi zonen , menyren e ndertimit , koeficientin e shfrytezimit te truallit, ushrimin e veprimtarise etj.

Trualli ne te cilen ndodhet objekti, shtrihet ne nje terren te sheshte ndersa prona eshte e karakterizuar nga nje siperfaqe uniforme ku efekti i erozionit nuk eshte i ndjeshem.

Objekti godine industriale ka nje siperfaqe ndertimi 114 m² dhe siperfaqe jasht objektit 46m².

Ndodhet ne zonen kadastrale Nr.3203, me Nr. Pasuriose 21.66.

Kufizimet: veriu 21/67; Lindja-21/68; Jugu 810; Perendimi -21/67; 21/78

Siperfaqja totale : 700 m².

Siper, pergj Katit pare : 114 m²;

Ne afersi te zones ku zhvillon aktivitetin subjekti nuk ka shkolla ,vepra arti, argjinatura, linje eletrike dhe linje uji qe mund te demtohen nga zhvillimi i aktivitetit nga subjekti.

Permiresimi urban i kesaj zone, e cila ka patur zhvillime mjaft te medha e te shpejta , urbanistike dinamike kohet e fundit vazhdon te terheq mjaft interesin e subjekteve privat.

Hapsira para ndertesës, eshte e sistemuar, dekoruar me lule e lulishte duke bere te mundur realizimin e nje imazhi pamor mjedisor shume cilesor ,cka dhe ka ndikuar ne permiresimin e pamjes vizuale.

Pervec interesit ekonomik , investitori ka bere rregullime ,sistemime te sheshit para objektit , rrugeve, ka krijuar hapsira te gjelberta.

PROCESI PRODHIMIT DHE KARAKTERISTIKA TE TIJ

Godina ku ushtron veprimtarine subjektit Fatos Gega, per prodhimin e ujit te pishem dhe pijeve jo alkalike nuk ka asnje lloj mbetjeje, pasi dhe ato kuti ose letra qe dalin u jepen kompanive te cilet i riciklojne.

Ne kete subjekt jane te punesuar rreth 3 punonjes te cilet jane trajnuar dhe specializuar ne fushen perkatese te ketij aktiviteti.

Subjekti perdor lende te pare 100 % uji natyral nga burimi qe del ne tynelin e Qaf Thanës, ku i nenshtrohet nje procesi teknologjik per pastrimin dhe sterilizimin e tij sipas standarteve te BE dhe per ta bere sa me konkurues ne treg, ku cikli i prodhimit dhe ruajtjes eshte teresisht i mbyllur dhe me kontakte teper minimale me elementet e mjedisit pra eshte miqesore me mjedisin pasi nuk ka asnje lloj mbetje.

1. Paisjet dhe Skema teknologjike e Linjes se prodhimit te ujit

Para filter per ujin –mekanik

Mates uji

Rezervuar uji 15000litra

Filter me kuarc

Filter me karbon

Filter uji 1 mikron

Ozonator

Rezervuar uji te gatshem 19000litra

Paisje e larjes se shisheve;

Paisje e mbushjes se shisheve

Elektropompa qe percjell ujin $q=0,6l/sek$ $h=20m$.

Pajisja e depozitimit te ujit

Pajisja e dezinfektimit me rreze

Pajisja e mbushjes se shisheve

Pajisja e etiketimit

Krahas tyre pjese e infrastruktures se linjes jane tubat e furnizimit dhe shkarkimit, kondravalvula te ndryshme, saracineska te ndryshme,, galixhante etj.

Ambalazhimi dhe mbushja e ujit behet me nje teknologji nder me te avancuarat, e realizuar nga firma me te njohura ne tregun europian , duke siguruar nje linje plotesisht automatike.

Subjekti me aktivitetin e zhvilluar deri me tani, bazuar ne marredheniet korrekte qe ka vendosur me klientet e tij, si dhe ne eksperiencen disavjecare dhe mbi te gjitha me cilesine e mire te sherbimit ka treguar se eshte serioze ne aktivitetin e biznesit qe zhvillon.

Cikli i punes eshte teresisht i mbyllur dhe me kontakte teper minimale me elementet e mjedisit pra eshte miqesore me mjedisin.

Zhurmat jane normale dhe jane te pranishme vetem gjate orarit te punes deri ne oren 16. Nuk ka shkarkime te ndryshme ne ambient.

Furnizimi me uje dhe energji eshte i plote dhe me kontrata te rregullta me OSHEE. Teknologjia e instaluar per veprimtarine e mesiperme eshte ne parametra optimale, dhe nuk le asnje lloj mbetjeje.

VLERESIMI I NDIKIMEVE ME TE RENDESISHME NE MJEDIS.

Duhet te minimizohen ndikimet ne mjedis gjate punes dhe aktivitetit qe kryhet ne kete subjekt.

Vleresimi mjedisor i territorit ku ushtron veprimtarine subjekti do te perqendrohet ne :

Evidentimin e parametrave fizike natyrore te truallit, te tokes, ujit dhe ajrit.

Evidentimin e elementeve me rendesi te vecante per ruajtje.

Vleresimi i burimeve si nga aktivitet antropgjene, si ndertimet banesat, ushtrimi i aktiviteteve ekonomike, tregtare, ndertimet infrastrukturore si dhe punimet inxhinierike me permasa te medha ne territor.

Evidentimin e vlerave panoramike dhe peisazhet natyrore te kesaj zone.

Duke patur parasysh karakterin e studimit , vleresimi mjedisor nuk hyn ne thellesi te elementeve dhe thellim te elementeve ekologjike, per te cilat do te kerkohen studime te vecanta ekologjiko-mjedisore. Parametrat dhe interpretimet mbeten ne kufij te interesave urbane te planifikimit me tendencen per gjetjen e nje zhvillimi te qendrueshem urban ne raport me mjedisin.

3.1. VLERESIM I NDIKIMEVE KRYESORE NE MJEDISIN E STUDIUAR.

3.1.1 Efektet ne cilesine e ajrit.

Nga zhvillimi i aktivitetit ngritja e pluhurave ne atmosfere do te jete e pandjeshme Ky subjekt nuk emeton pluhura.

Ndikimet ne shendet, nga ndotes si : NO₂ , PM₁₀. NO_x,CO₂,N₂O₂ , jane te paperfillshme pasi makinat qe do te levizin jane te pakta.

3.1.2 Vibrimi dhe zhurmat.

Zhurmat ne Godinen ku ushtron veprimtarine subjekti , do te jene te paperfillshme, pasi ndertimet kane karakter te njejte, dhe ndodhet ne ne nje zone me destinacion teresisht tregtimit dhe sociale Zhurma eshte nje tingull i padeshiruar, niveli i zhurmes te mos i kaloje normat sipas udhezimit Nr.8

3.1.3 Ndikimet ne toke dhe erozioni i saj.

Kjo zone nuk ka predispozim per erozion.

Disa ndikime ne toke:

Ndikimet fizike te projektit me ndryshime topografike lokale dhe ne erozionin e tokes:

Gjate shfrytezimit nuk pritet te kete ndryshime ne topografine lokale. Ne projekt eshte parashikuar nje radhe dhe drejtim i tille shfrytezimi, qe ne kombinim me masat e tjera suplementare si hapja e kanaleve te drenazhimit, sistemimin e truallit,shtrimin e nje pjese te saje me beton kane parandaluar erozionin.

3.1.4 Ndikimet e projektit ne modelin drenazhues te zones.

Zona ku ushtron aktivitetin subjekti , eshte nje zone fushore. Ne kete zone ka objekte egzistues qe e kane sistemin e drenazhimit egzistues pasi infrastruktura e kesaj zone eshte ndertuar rishtazi.

Ndryshimet e karakteristikave te tjera hidrografie:

Ne zonen e shfrytezimit perreth saj nga konstatimet ne terren nuk vihet re prania e ujerave siperfaqesore ne afersi te kesaj prone. Ndikimet ne rrjetin hidrologjik jane te pa perfillshme sepse aty eshte zone e urbanizuar dhe aktualishte plotesuar me ndertime te reja.

3.1.5 Ndikimet ne ujerat nentokesore.

Nuk do te kete ndonje ndotje nga lende helmuese pasi ato nuk jane te pranishme

3.1.6 Ndikimet ne flore dhe faune.

Zona ne fjale priret nga nje zhvillim i pasur i flores dhe i faunes. Vete natyra e aktivitetit bene qe ndikimi ne flore te mos kete. Sidoqofte masat zbutese gjate veprimtarise do te kihen ne konsiderate.

3.1.7 Ndikime te tjera indirekte qe shoqerojne projektin.

Gjate ushtrimit te aktivitetit nga subjekti te do te kete ndikime te pakta ne trafikun rrugor, ndersa ne trafikun ajror, hekurudhor dhe lumor nuk do te kete ndikim te drejtperdrejt. Objekti lidhet me rrugen kryesore Prrrenjas-Pogradec. Transporti i materialeve do te behet nepermjet rrugeve nacionale .

4. PERMBLEDHJE E EFEKTEVE KRYESORE QE NDIKOJNE NE MJEDIS.

4 Gjate periudhes se shfrytezimit shfaqen keto efekte:

- a) Ndotja e ajrit ne nivele teper te ulta nga mjetet qe do hyjne e dalin ne territorin e objektit
- b) Konsumimi i energjise elektrike dhe i ujit per konsum.
- c) Ne shtimin ne nivele teper te ulta te ujerave te ndotura urbane, (nga e larja e pastrimi), te cilat do te derdhen ne rrjetin e kanalizimeve te kesaj zone .

4.2. Efektet kryesore pozitive.

Gjate funksionimit shfaqen keto efekte pozitive:

- a) Do te ndikojne ne rritjen e ekonomise
- b) Rregullimet ne territorin perreth nuk do te behet pengese per trafikun rrugor dhe as burim aksidentesh, pasi eshte projektuar konform kushteve teknike dhe me sinjalistikat perkatese.
- c) Aktiviteti qe do te kryej subjekti nuk do te shkaktojte ndotje te tokes, pasi nuk ka dhe as nuk do te kete shkarkime ne mjedis te hapur.
- d) Krijimi i mjediseve te gjelberuara.
- e) Gjate punes, ujerat urbane nuk do te paraqesin nje shqetesim dhe problem mjedisor, pasi ato derdhen ne kanalizime.
- f) Punesim te banoreve te zones, ka rreth 4 te punesuar

5.MASAT ZBUTESE.

Ne projekt eshte percaktuar shfrytezimi harmonik dhe i kombinuar ne kohe dhe ne hapesire i zones ne teresi dhe i siperfaqes se godines .

Eshte sistemimuar sheshi, rruga hyrese dhe rrugicat brenda objektit jane te sistemuara duke evituar keshtu pluhurin, trafikun, erozionin, etj. si rezultat i qarkullimit te automjeteve dhe reshjeve.

Ndonje mbetje qe do te gjenerojte, te ngurtat qe dalin nga linja industriale do te depozitohen ne vendin e caktuar nga Komuna Rrajce. E rendesishme eshte te evitohet depozitimi i tyre ne vende te pa lejuara, (ne kazanet e mbetjeve urbane te fshatit) por ato te terhiqen nga firma e licensuar.

Furnizimin me uje , subjekti e ka bere duke marre ate nga rrjeti egzistues i zones, gjithashtu ka edhe nje depozite te vecante e cila eshte ne gadishmeri per tu shfrytezuar per raste avarie apo te emergjences sic eshte rasti renies se zjarrit.

Ujerat e zeza dhe te bardha grumbullohen ne grope septike dhe pastaj derdhen ne rrjetin e kanalizimeve te kesaj zone.

Furnizimi me energji elektrike eshte realizuar me ane te linjes elektrike ne perputhje me kushtet qe ka percaktuar Drejtoria perkatese e OSHEE.

A. Kerkesa shendetesore dhe mjedisore gjate fazes ndertuese:

Per parandalimin e ndikimeve negative ne shendet e ne mjedis qe mund te lindin gjate operacioneve te ndryshme te punes, ku ushtron veprimtarine subjekti, do te kete parasysh dhe te respektojte kerkesat e Rregullores Nr.1, date 15.03.2006 "Per parandalimin e ndikimeve negative ne shendet e ne mjedis ", ku administratori do te marre masa kryesore sic jane :

1. Subjekti do te zbatoje kerkesat e Lejes Mjedisore si dhe normat e standardet qe kane te bejne me mbrojtjen e mjedisit dhe shendetit nga ndikimet negative te veprimtarise.
2. Subjekti do te zbattojte te gjitha normat higjieno sanitare si per mjedisin e brendshem, mjedisin e jashtem dhe cilesine e ujit
3. Subjekti do te siguroje zbatimin e masave qe parandalojne ndotjen e mjedisit dhe shkarkimet mbi normen e lejuar per ajrin, per ujin dhe per token, pakesimin dhe riperdorimin e mbetjeve qe gjeneron veprimtaria , kthimin e vendit ne kushte te kenaqshme mjedisore pas perfundimit te veprimtarise si dhe respektimin e kerkesave dhe te kushteve te LejesMjedisore te Leshuar nga AKM-ja

Per mbrojtjen e cilesise se ajrit:

Objekti gjate kohes do te laje mjedisin perreth nje deri dy here ne dite per te reduktuar qlirimet e pluhurave.

Subjekti do te administroje mbetjet qe gjenerohen nga veprimtaria e prodhimit, duke marre masa si me poshte:

Mbetjet do te largohen cdo dite dhe te dergohen ne vendgrumbullimet e percaktuara nga Komuna Rrajce, ose te terhiqen nga firme pastruese e licensuar per kete lloj shebimi.

Furnizimi me lende te pare dhe transporti i produkteve te prodhuara do te behet ne oret me trafik te pakesuar.

Do te pastrohen menjehere rrjedhjet, derdhjet, pikimet qe mund te shkaktojne automjetet gjate transportit, per te parandaluar ndotjen e tokes.

Per uljen e niveleve te zhurmave:

Do te respektohen standardet e normativat per nivelin e zhurmave te lejuar sipas standartit te BE-se ; 55 Laeq /Diten dhe 35 Laeq /Naten, por naten nuk punohet.

I gjithë personeli qe do te punesohet do te eshte trajnohet nga specialistet perkates te subjektit per menyren e veprimit ne rast aksidentesh, kordinimit te operacioneve dhe nderhyrjes efikase. Punonjësit janë udhëzuar të bejnë një përdorim të duhur të ujit të pijshëm dhe energjisë elektrike. Ata janë tepër të kujdesshëm për një përdorim sa më të përshtatshëm të këtyre dy burimeve.

6. RREZIKU PER AKSIDENTE.

Zbatimi i ketij projekti nuk do te sjelle rrezikshmeri per aksidente, duke qene se nuk do te kete mbajtje ose perdorim te substancave te rrezikshme. Kujdes i duhet kushtuar mbrotjes nga rryma eletrike. Ne rast se do te kete ndonje derdhje te lendeve : si hidrokarbure apo lubrifikante nga automjetet e transportit, do te merren masa per pastrimin e saj dhe dergimin ne vendin e caktuar nga vete subjekti e me pas te evadohen nga subjekti privat i licensuar per kete veprimtari.

6.1. Sigurimi teknik dhe mbrojtja ne pune.

Objekti eshte i ndertuar me planimetri te rregullt dhe ka respektuar kriteret teknike per funksionimin normal te tij. Ai ka siperfaqe te mjaftueshme per kryerjen e proceseve te levizjes se mjeteve, shkarkimeve te lendes se pare e materialeve, magazinimin ,perpunimin dhe sistemimin e tyre ne sektore te vecante , per parkim, dhomat higjenike, dhomat e zhveshjes, etj. Jane ndertuar dhe funksionojne WC . Rrjeti elektrik i objektit eshte bere i ri.

7. MONITORIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS TE PROJEKTIT.

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokes, derdhjeve urbane etj, kryhet sipas disa kriterëve shkencore persa i perket vrojttimeve, mbledhjes dhe analizave te mostrave. Ai synon ne mbledhjen e te dhenave per te vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror ne ndryshimet e mjedisit, ku ai eshte aktiv.

Monitorimi eshte detyre e investitorit per pikat ç1, ç 2, ç 5, ç 6, ç 7, ç 8 te ligjit "Per monitorimit e mjedisit ne RSH", kreu III, pika 10.

Keto te dhena te dergohen prane AKM-se dhe ARM-se Elbasan cdo 6 muaj.

a)Monitorimi i tokes .

Nuk ka shkarkime ndotje te tokes por,nese mund te kete ndonje rast te vecante ndotje, shkarkim lubrifikanti,etj mund te behen analizat e te raportohet.

b)Monitorimi i mbetjeve te ngurta .

Ne kete aktivitet nuk ka asnje lloj mbetjeje, pasi dhe ato kuti ose letra qe dalin u jepen kompanive te riciklimit te letres dhe kartonit.

c) Monitorimi i mbetjeve te lengeta.

Mund te behet vetem ne rastet kur konstatohet se ka ndotje nga mbetjet e lengeta, por ato dergohen ne puseta dekantuese e pastaj ne kanalet kulluese te zones.

d) Monitorimi i ajrit.

Mund te behet vetem ne rastet kur konstatohet se ka ndotje nga ; pluhurat apo nga gazrat e makinave, por gjithsesi nga puna ne kete subjekt , nje ndotje e tille nuk ka ,ose mund te jete e pa perfillshme.

Programi i monitorimit do te perdoret per te verifikuar te gjitha ndotjet emundshme qe mund ti shkaktohen mjedisit gjate punes (shfrytezimit) .

Subjekti do te beje vetemonitorimin me ane te analizave te kryera nga Institucione te akredituara dhe keto te dhena te dergohen prane AKM.

8.REKOMANDIME

- a. Dyshemja te jete e shtruar e niveluar, dhe e izoluar nga lageshtira pasi pajisjet punojne me energji eletrike.
- b. Mbeturinat do te krijohen gjate punes te grumbullohen, transportohen dhe depozitohen ne vendin e caktuar nga Komuna.
- c. Nderhyrjet ne rrjetin e infrastruktures te kryhen me lejen e institucioneve perkatese.
- d. Subjekti do te ushtroje veprimtarine prodhim uji te pishem dhe pije jo alkalike dhe nuk do ti ndryshohet qellimi.
- e. Te mbaje paster e te pastroje ambjentin brenda godines e jashte saj.
- f. Furnizimi me energji te behet sipas projektit dhe miratimit te OSHEE.
- g. Ne te gjitha repartet e permendura te vendosen kosha per grumbullimin e mbetjeve te ngurta .
- h. Te mbahet nen kontroll ndricimi brenda linje se prodhimit dhe perreth (vendosja e instalimeve te ndricimit).
- i. Te mbahen nen kontroll instalimet ne nderteses dhe jashte saje: si pompat e ujit, instalimet energjetike, etj per te mos shkaktuar ndotje mjedisore.
- j. Subjekti me aktivitetin e tij Prodhim uji dhe pije jo alkalike te respektoj detyrimet qe percaktohen ne Lejen Mjedisore te miratuar nga AKM-ja.

9. Konkluzione

Nga sa eshte verifikuar dhe matur ne vend dhe qe pasqyrohet ne kete raport te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis te veprimtarise se mesiperme rezulton se ushtrimi i ketij aktivitetit behet konform te gjitha rregullave te siper marrjes se lire te biznesit privat vendas. Ne materialin e mesiperme shihet qarte se ky eshte nje ndikim minimal dhe pothuajse i paperfillshem por gjithsesi kompania eshte e ndergjegjshme se sado minimal ky ndikim duhet te miremenaxhohet dhe te behen prepjekje teknike per te bere kete ndikim me vlere zero.

Subjekti me aktivitet "Prodhim dhe ambalazhim uji dhe pijeve jo alkalike" do ta ushtroje veprimtarine ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fushen e mbrojtjes se mjedisit dhe do te investoje per permiresimin e mjedisit, punes dhe do te mirepresin cdo sygjerim ne te mire te cilesise se punes, si dhe aktiviteti do te beje te mundur zbutjen e papunesise ne kete zone, duke bere punesuar nje pjese te mire te banoreve te kesaj zone.

Ekspert mjedisor

Yzeir MIRAKA